



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0598**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (OE) “Labinot M.Krasniqi” B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e ndriqimit publik “ me nr. të prokurimit: "615-23-4701-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujeves me datën 12.10.2023, mori këtë:

## **Vendim**

**1. Refuzohet**, ankesa e operatorit ekonomik “Labinot M.Krasniqi” B.I., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21.08.2023 (me numër protokolli 598/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e ndriqimit publik “ me nr. të prokurimit: "615-23-4701-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujeves.

**2. Të mbetet ne fuqi** vendimi I Autoritetit Kontraktues.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues është refuzuar si e papabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 16.05.2023, Komuna e Podujeves , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e ndriqimit publik” me nr. të prokurimit:” 615-23-4701-2-2-1 "Nderkaq me datën 02.08.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Labinot M.Krasniqi” B.I me datën 07.08.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 10.08.2023, AK-Komuna e Podujeves me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesat per rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Labinot M.Krasniqi” B.I. me datën 21.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 598/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Sherbim, vlera e parashikuar e kontratës: 50.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

#### ***- Vlerësimi dhe administrimi i provave –***

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 31.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Labinot M.Krasniqi” B.I,

**I. Refuzohet,** ankesa e operatorit ekonomik “Labinot M.Krasniqi” B.I., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21.08.2023 (me numër protokollit 598/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e ndriqimit publik “ me nr. të prokurimit: "615-23-4701-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujeves.

**II. Të mbetet ne fuqi** vendimi I Autoritetit Kontraktues.

#### **PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES**

##### **Pretendimi nr.1**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-Komunës se Podujevës ka parashtruar ankesë në OSHP, me pretendimin për shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurim Publik, konkretisht pretendon se eliminimi i ofertës është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 61 të LPP-se dhe kryesisht pretendon se AK-ja, ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, e ka njoftuar OE ankues me rezultatin e vlerësimit, ku OE ankues e eliminon me arsyetimin se ka ofruar çmim Jo/Normalishte të ulët, në disa pozicione dhe se përgjigja e dërguar nga OE ankues, nuk ka qenë bindëse për komisionin dhe se si AK, kemi kërkuar të dëshmoni me fatura të furnizimit nga ndonjë prodhues.

Eksperti shqyrtues, sqaron se gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, konkretisht me datë: 29.06.2023, ka kërkuar sqarime për disa pozicione të paramasës së OE ankues, nga i cili është

kërkuar sqarim i detajuar për këto pozicione.

7	Punimi i Bazamentit te ormanit. Betonimi i bazes se Kuadrit kryesor shpërndarës (ormanit) MB30 me dimensione (1.30x0.40x0.50)m, ku në qmim të hyj germimi i dheut dhe sasia e betonit dhe gypat PVC Ø63 mm.	copë	1	0.5	€	0.50	€	0.35
8	Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m , vendosja e shtyllave të betonit duhet të jen me standarte të KEDS-it, ku në këtë qmim duhet të llogaritet: <b>a)</b> hapja(germimi i dheut) e gropes me dimensione 0.4*1.5 m <b>b)</b> sasisa e betonit per bazament për shtyllat sipas dimensioneve standardeve, <b>c)</b> Sasia e tepert e dheut duhet të transportohet në lokacionin e caktuar nga Menaxheri i projektit. Gjatë punimeve të vendosët masat mbrojtse sinjalizuese në rrugë nga O E.	copë	1	12	€	12.00	€	8.40
9	Furnizimi dhe montimi i shtyllave me gjatësi 4m , të punuar nga çeliku i Zinkuar, të mbrojtura nga koruzioni me dy shtresa si në Parkun e Qytetit te Pishat (Parku I Paqes).	copë	1	2.5	€	2.50	€	1.75
10	Furnizimi dhe montimi i shtyllave me gjatësi 3.5-4m' me trupa ndriçues (Eficient) , si në Parkun e Qytetit.	copë	1	2	€	2.00	€	1.40
11	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike të zingtuar 8.8m me këto karakteristika: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trashësia e mureve të shtyllës 4mm.</li> <li>• Me hot dip galvanizim të nxehtë</li> <li>• Lartësia e shtyllës mbi toke h1= 8.8 m</li> <li>• Diametri i shtyllës në maje d1= 60 mm</li> <li>• Diametri ne fund të shtyllës d2= 148 mm,</li> </ul> Vendosja e shtyllave të duhet të jenë me standarte të KEDS-it, ku në këtë qmim duhet të llogaritet: <b>a)</b> hapja(germimi i dheut) e gropes me dimensione 0.4*0.8*0.4 m, <b>b)</b> sasisa e betonit për bazament për shtyllat sipas dimensioneve standardeve, <b>c)</b> Pllaka e hekurit se bashku me bulonat që duhet të vendosen në beton për përforcim të shtyllës, <b>d)</b> Sasia e teper e dheut që duhet të transportohet në lokacionin e caktuar nga Menaxheri i projektit. Bazamenti për shtyllat e metalike mundë të bëhët edhe me "mbjellje" , të shtyllave, ku duhet llogaritur edhe gypi Ø300 mm,me gjatësi prej 1 m ), dhe sasia e zhavorit 0.2 mm, dhe betoni për pllak të betonit 0.5*0.5 m me t=10 cm, kjo pllak venosët pas vendosjes së shtyllës	copë	1	12	€	12.00	€	8.40

21	Furnizimi ,transporti dhe montimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjatë shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbrazur rezerve të mbrojtur e Dekarpiruar me dim (120 x 90 x 30). Ndërprerës AS 160A...1copë ,					
	- Poç fluroshent 1x18w me bazë 1copë					
	- Prizë OG 16 A 1 copë					
	- Ndërprerës zgjedhës për kyqje të Ndriçimit I=80A-u-RG10 (me dy pozita 1-0-2)... 1 copë					
	- Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1... copë					
	- 2 dalje ORS - siguresa 6 copë patron 63/A					
	- Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë					
	- Përçues 1x25 mm 2 (m) 15					
	- Kontaktorë tip CS 160 2 copë					
	Komplet me shtrëngues dhe material tjetër (gypat ) si dhe skema njëpolëshe e vendosur brenda dhe numri i ormanit i vendosur jashtë si dhe shenja e rrezikut .Ormani i ndriçimit duhet të ketë 2 dalje për ndriçim dhe një hyrje për furnizim ,qelës trekëndësh si dhe paisjet duhet të vendosen sipas paisjeve të gjendjes ekzistuese të ormanëve të ri.	copë	1	1.5	€ 1.50	€ 1.05

22	Furnizimi dhe montimi i ormanit te ndricimit publik i thatë per montim të jashtëm(montimi në shtyllë). Dimensionet e ormanit jane 0.8x0.6x0.2m. Ormani duhet te jetë i punuar nga llamarina 2mm e zingtuar dhe dy here e plastifikuar .	copë	1	2	€ 2.00	€ 1.40
23	Furnizimi dhe montimi i Shkarkuesve TU e tipit STH 3P+N me karakteristika specifike teknike te shkarkuesit: I <sub>max</sub> (8/20μs)-65kA; I <sub>n</sub> (8/20μs)-20kA ; U <sub>p</sub> =1,5kA	copë	1	0.2	€ 0.20	€ 0.14

37	Furnizimi dhe vendosja e ndërprerësve të fuqisë të tipit prej (AS-40-160) A, që do të vendosen në ormanet kryesor	copë	1	0.2	€ 0.20	€ 0.06
----	---	------	---	-----	--------	--------

39	Furnizimi dhe montimi i ndërprerësve të tipit RG- 35- me dy pozita (1-0-2)	copë	1	0.5	€ 0.50	€ 0.15
----	--	------	---	-----	--------	--------

41	Furnizimi dhe montimi i siguresave 1p/10A per ndriçim te vendosur ne pllaken e Araludit.	copë	1	0.5	€ 0.50	€ 0.15
----	--	------	---	-----	--------	--------

AK-ja, kërkuar që për pozicionet OE ankues të ofruar dëshmi bindëse nga prodhuesi apo me fatura të furnizimit në mënyrë që të argumentohet se kjo kontratë mund të realizohet me këto çmime.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të shkresave të lëndës, kërkesën e AK-se drejtuar OE ankues, përgjigjen e OE ankues në kërkesën e AK-se, vlerëson se AK-ja ka vepruar në harmoi me nenin 4 re rregullores për çmime Jo/Normalishte të ulëta dhe 61 të LPP-se.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se në bazë të paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-se, vlerësimi i çmimeve pas marrjes së informacioneve nga OE ankues, është në të drejtën e autoritetit kontaktues të vlerësojë informacionet e ofruara.

Poashtu eksperti shqyrtues, sqaron faktin se ne përgjigje OE ankues nuk i ka ofruar dëshmitë sipas kërkesës se datës: 29.06.2023 te autoritetit kontraktues, sepse AK-ja, ka kërkuar fatura te furnizimit, ndërsa OE ankues ka ofruar disa marrëveshje me kompani qe e furnizojnë.

Lidhur me çmimet e paramases OE ankues, e konsideron diskriminuese faktin se AK-ja, nuk i ka trajtuar ne mënyrë te barabarte, me arsyetimin se edhe i rekomanduari për kontrate, ka ofruar çmime Jo/Normalishte te ulëta dhe te njëjtë nuk i ka kërkuar sqarime lidhur me çmimet.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ankesën e tij OE ankues i përmend disa pozicione te OE te rekomanduar për kontrate, nder te cilat janë pozicione te cilat janë te njëjta me ato te cilat ka kërkuar sqarim AK-ja.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne pozicionin nr.: 7 OE ankues, ka ofruar çmim: 0.50 euro/cent, ndërsa i rekomanduari për kontrate 1.00 euro. Ne pozicionin nr: 8 OE ankues, ka ofruar çmim: 12 euro, ndërsa i rekomanduari për kontrate 65.00 euro, pastaj ne pozicionin nr: 22 OE ankues, ka ofruar çmim: 2.00 euro, ndërsa i rekomanduari për kontrate 25.00 euro. Ne total gjithesej OE ankues i përmend 15 pozicione.

Eksperti shqyrtues, siç e ka sqaruar edhe me larte nuk qëndron ky pretendim sepse vlerësimi i çmimeve është e drejte e autoritetit kontraktues.

OE ankues, ne ankesën e tij pretendon se AK-ja rekomanduar për kontrate një operator ekonomik te papërgjegjshëm, ku sipas OE ankues, i rekomanduari për kontrate, pretendon se nga pajisje qe janë kërkuar vetëm njëren e ka ofruar.

AK-ja, ne dosje te tenderit, ka kërkuar:

#### **Aneksi 7. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM**

1. Autoshportë – minimumi 19 m
2. Autoshportë – minimumi 11m

Konkretisht OE ankues, pretendon se për pajisjen nr: 2, OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar një marrëveshje e cila nuk është valide sepse nuk ka te dhëna te korpes dhe nuk ekziston asnjë dokument i saj apo libreze.

Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim për faktin se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar marrëveshje te cilën ka marr ne shfrytëzim dhe ne këtë marrëveshje janë te dhënat e korpes dhe për te njëjtën ka ofruar edhe librezën, poashtu si dëshmi ka ofruar edhe foto te pajisjes ne fjale.

A	Nomeni i regjistrimit; Код регистрације; Registration number;	01-827-PF
I	Data e regjistrimit; Датум регистрације; Date of registration;	18.03.2021
C	Të dhënat personale; Лични подаци; Personal data;	
C.2	Pranarit i mjetit; Власник возила; Owner of the vehicle;	
C.2.1	Mbipreni ose emri i biznesit; Презиме или пословно име; Surname or business name;	Fatmir Imava B.I.
C.2.2	Emri; Име; Name;	
C.2.3	Adresa; Адреса; Address;	Lot Vaku Prishtinë
B	Data e regjistrimit të parit; Датум прве регистрације; Date of first registration;	07.05.2008
D	Automjeti; Возило; Vehicle;	
D.1	Prodhuari; Произвођај; Make;	MERCEDES-BENZ
D.2	Tipi; Тип; Type;	906KA50

D3	Preshkrimet komerciale; Комерцијална описица; Commercial description(s);	Sprinter 515 Cdi
E	Nomeni identifikues i automjetit; Идентификациони број возила; Vehicle identification number;	WDB9066531S178161
S	Viti i prodhimit; Година изработки; Year of production;	2008
S	Kapaciteti i ulësve; Капацитет седишта; Seating capacity;	2
S.1	Nomeri i ulësve; Број седишта; Number of seats;	
S.2	Nomeri i vendeve për qëndrim; Број седишта за трајект; Number of standing places;	
Q	Raporti Peshë-Potenci (në kW/kg); Однос масе/момент моќи; Power/Weight ratio (in kW/kg);	
F	Pesha; Маса; Mass;	5000
F1	Pesha maksimale e regjistruar në lejuar; Максимална позвольна маса; Maximum permissible laden mass;	690
G	Pesha e automjetit; Маса возила; Mass of the vehicle;	4310
K	Homologimi; Хомологација; Type of approval;	

P	Motori; Мотор; Engine;	
P1	Kapaciteti (në cm3); Запонска (in cm3); Capacity (in cm3);	2148
P2	Fuqia maksimale neto (në kW); Максимална нето моќ (in kW); Maximum net power (in kW);	
P3	Lloji i karburantit ose burimi i energjitë; Типа горива или извора моќи; Type of fuel or power source;	Dizel
R	Niveli i ndërtimit; Степен изградње; Color of the vehicle;	0 - E BARDHË
2A	Ndërtimi; Конструкција; Construction;	Purgoni me shportë me 4 dyer

Shënime;  
Забелешки;  
Remarks;

N.N.P. \* Ndërtimi \*  
AUTOMJETI POSEDON XHAMA  
TË PASMË TË ERËSUAR NGA  
PRODHUESI.

Marrëveshja është arritur në mes të Huadhënësit dhe Huamarrësit për mjetet (makineritë) e dhëna në vijim:

Nr	Lloji i makinës	sasia
1	Korpë 14 m lartesi, Mercedesi Sprinter	1 cope

Vërejtje: Librezat dhe dokumentet tjera përcjellëse gjeni të bashkëngjitura.

Kjo marrëveshje u lidh në Prishtinë, me datë: 06.06.2023

NNP "NDRIQIMI"  
Prishtinë

SH.P.K. INLINE ENGINEERING  
VALON HASANI

Lidhur me marrëveshjen e dhënë me lart, OE ankues pretendon se kjo marrëveshje është e dyshimt, duke e arsyetuar se kjo marrëveshje e ka të skanuar nënshkrimin dhe vulën.

Duke pas parasysh faktin se ne platformën e E-Prokurimit te gjitha deshmit janë te skanuara nuk mund te perdore si baze e dyshimit për falsifikim, fakti se dokumenti është i skanuar, sepse dokumenti ne fjale ne tërësi është i skanuar dhe jo vetëm vula dhe nënshkrimi.

*- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij. Dhe arsyet e mbështjetjes së këtij raporti sidomos sa i përket çmimeve jo-normalisht të ulëta si për vetë ofertën e tij po ashtu edhe ndaj çmimeve të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë provë se këto çmime janë apo nuk janë çmime të tregut. Andaj në mungesë të këtyre provave paneli shqyrtues është i detyruar të veprojë konform vendimit të AK dhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues profesional. Kështu që, AK konform nenit 24, paragrafit 2 të LPP "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj"

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukon apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

*- Përfundim -*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 dhe 61 të LPP, të cituara në Ankesë, meqë e ka hartuar dosjen e

tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) lidhur me nenin 28 (Specifikimet teknike) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PODUJEVËS**
- **OE - Labinot M. Krasniqi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: